



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 541/ 2 prot.,

Datë 16.03.2022

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” me Nr. REF-16711-12-29-2021, me objekt “*Blerje artikuj tonera për printera dhe fotokopje*” me fond limit: 4,142,773.60 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 25.02.2022 nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK.
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 8, Kashar - Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
Adresa: Ruga “Sami Frashëri”, nr. 8, Tiranë.

Në datën 15.03.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 541 e operatorit ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” me Nr. REF-16711-12-29-2021, me objekt “*Blerje artikuj tonera për printera dhe fotokopje*” me fond limit: 4,142,773.60 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 25.02.2022 nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “*Infosoft Office*” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “Infosoft Office” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 541 prot., datë 15.03.2022.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Kriteri (1) i specifikimeve teknike (shtojca 5) rezulton i pa plotësuar nga operatori ekonomik për tonerin Laser Jet Pro 3015

Q2612AD ku part/number (Kodi) i dorëzuar nuk përputhet me atë të kërkuar:

• *Laser Jet Pro 3015 Q2612AC.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 16.03.2022.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri